



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:055167

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05828192

K.DH.SHK.II.nr.1067/2024

**GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Dren Rogova, anëtarë të kolegjit, në kontestin tregtar administrativ të paditësit S.I. BI me NUI811447045 me seli ne fshatin Sllatinë e Epërme-Viti, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, lidhur me kërkesën e përsëritur te paditësit-propozuesit për shtyrje te ekzekutimit vendimit te paditurës nr. 573/2023 dt. 02.02.2024, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.100/24, i datës 26.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.10.06.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues S.I. BI me NUI811447045 me seli ne fshatin Sllatinë e Epërme-Viti, ndërsa Aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.100/24, i datës 26.04.2024, Vërtetohet.

#### A R S Y E T I M

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, e ka hedhe poshtë propozimi e paditësit-propozuesit S.I. BI për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024, për shkak se ekziston vendimi i formës se prerë i nxjerr ne konfliktin administrativ për te njëjtën çështje.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata të aprovoj ankesën si të bazuar, të prishe këtë aktvendim dhe të kthej çështjen ri gjykim.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 194 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi propozuesi S.I. BI ka përsëritur kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024, në Gjykatën Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, ka paraqitur propozim për herën e dyte me të cilën kanë kërkuar që shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024, për arsye se ka paraqite prova te reja.

Gjykata Komerciale–Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve të sigurimit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhomat e shkallës së parë, thekson se pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024, ka gjetur se propozimi i tillë është i palejueshëm pasi gjykata e shkallës së parë për shkaqe arsye te njëjta dhe ne ndaj vendimit te njëjta mes te njëjtave palëve ndërgjyqëse ka vendos tani me vendimin gjykata Komerciale Departamenti Fiskal me vendimin KFnr. 100/24 dt. 21.02.2024 dhe i vërtetuar me Aktvendimin e shkallës se dyte te Gjykatës Komerciale nr. KF nr. 707/24 dt.25.03.2024, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur asnjë rrethanat tjetër për te cilat do te vlerësoj gjykata, mirëpo për shkaqe te njëjta ndaj njëjtin vendim kërkon shtyrjen për te cilin tani me është vendosur me vendim te formës se prerë. Gjykata tutje ka arsyetuar se nuk mundet te shqyrtoj ne merita kërkesën për shtyrje e ekzekutimit te aktit administrative vetëm ne baze te provave, te cilat paraqiten për te arsyetuar edhe mjetin juridik te rishikimit nga neni 53 i LKA-se, kjo për faktin se provat e reja gjykata duhet ti vlerësoj me rastin e shqyrtimit te mjetit të rishikimit. Andaj ne baze te nenit 34 parag 1 pika 1,6 te LKA-se e ka hedhe poshtë propozimit e paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024, ka gjetur se propozimi i tillë është i palejueshëm pasi gjykata e shkallës së parë për shkaqe arsye te njëjta dhe ne ndaj vendimit te njëjta mes te njëjtave palëve ndërgjyqëse ka vendos tani me vendimin gjykata Komerciale Departamenti Fiskal me vendimin KFnr. 100/24 dt. 21.02.2024 dhe i vërtetuar me Aktvendimin e shkallës se dyte te Gjykatës Komerciale nr. KF nr. 707/24 dt.25.03.2024, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur asnjë rrethanat tjetër për te cilat do te vlerësoj gjykata, mirëpo për shkaqe te njëjta ndaj njëjtin vendim kërkon shtyrjen për te cilin tani me është vendosur me vendim te formës se prerë. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, me te drejt ka hedhe poshtë kërkesën për shtyrje te ekzekutimit pasi qe paditësi për te njëjtat arsye ka paraqit kërkesën për shtyrje te

vendimit kontestuese-vendimit të paditurës, nr. 573/2023 dt. 02.02.2024 e ndaj vendimit te njëjte tani me ekziston vendimi i formës se prerë i nxjerr ne konfliktin administrativ për te njëjtën çështje.

Gjykata konsideron se, në bazë të fakteve të lëndës konkrete të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e shkallës se pare ka dhënë arsyetime të detajuara dhe të qarta për vendosjen e vet, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat e hedhë poshtë kërkesat e parashtruesit, si në aktvendimin e atakuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Kolegji i Shkalles se dyte të Gjykatës Komerciale e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkalles së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktvendimit.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes. Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të goditur.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktvendimit dhe se aktvendimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kolegji i kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:055167  
Datë: 18.06.2024  
Numri i dokumentit: 05828192

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SHK.II.nr.1067/24 me datë 10.06.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi